

School District of Philadelphia-s: Udhëzimet e regjistrimit

Përmbledhje:

Kur një nxënës aplikon që të pranohet në ndonjë shkollë, shkolla ka përgjegjësi të përfundojë regjistrimin nëse ai/ajo banon në zonën e mbuluar, ose duhet të japë menjëherë informacion se ku duhet të aplikojë nxënësi. Të gjitha regjistrimet në SIS për nxënësit në shkollat e qytetit, për shkollat e mbështetura në kritere dhe në shkollat jashtë zonës së mbuluar të nxënësve, duhet patjetër të bëhen nga Zyra e Regjistrimit dhe vendosjes së studentëve. Dokumentet e regjistrimit do të merren dhe do të shqyrtohen në shkollë.

Procedurat:

Një fëmije duhet t'i lejohet frekuentimi i shkollës ditën pasuese të shkollës, pas ditës ku fëmija paraqitet për regjistrim dhe në të gjitha rastet brenda pesë (5) ditëve pune pas marrjes së dokumentacionit të kërkuar nga rrethi shkollor. [22 Pa. Kodi §11.11 \(b\)](#).

Informacion i kërkuar:

Si pjesë e përpjekjeve të rrethit për të mbajtur një mjedis të sigurt për nxënësit, shkollat mund të kërkojnë sa më poshtë:

- Mund të kërkohej një kopje e identifikimit me fotografi të prindit/kujdestarit, **por nuk kërkohet** për regjistrim. Pasi të sigurohet, një kopje e ID-së me foto do të mbahet në dosje për qëllime verifikimi të identifikimit të personave të cilët janë të autorizuar të shoqërojnë fëmijën për në shkollë dhe kthimin nga shkolla.
- Përveç kësaj, shkolla **mund të kërkojë** të dhëna shëndetësore ose të ekzaminimit fizik që mund të ketë pasur, të dhëna akademike, të dhëna të frekuentimit, Programin e Individualizuar të Arsimit dhe të arsimit special, me qëllim që studenti të vendoset në nivelin e duhur të klasës me nivelin e duhur të mbështetjes.

Ju lutem kini parasysh: Edhe pse shkollat mund t'i kërkojnë këto informacione, ata mund të mos i kërkojnë si kusht për regjistrimin, ose pranimin e një fëmije dhe nuk mund të vonojnë regjistrimin, ose frekuentimin e një fëmije derisa këto dokumente të sigurohen. Shkolla mund të kontaktojë me prindin/kujdestarin lidhur me këtë informacion, pasi fëmija të jetë regjistruar në shkollë.

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Dëshmia e moshës së fëmijës (kërkohej si më poshtë)

Dokumentacioni i pranueshëm përfshin (më poshtë janë shembuj dhe jo një listë përfundimtare):

- Certifikata origjinale e lindjes së fëmijës
- Kopje e noterizuar e certifikatës së lindjes së fëmijës
- Pasaporta e fëmijës të jetë e vlefshme
- Certifikata origjinale e pagëzimit, e cila tregon datën e lindjes së fëmijës
- Kopje e regjistrimit të pagëzimit – e noterizuar ose e certifikuar në mënyrë të saktë dhe që tregon datën e lindjes



- Deklaratë e noterizuar nga prindërit, ose nga një i afërm tjetër që tregon datën e lindjes
- Të dhënat e mëparshme të shkollës, që tregojnë datën e lindjes

2. **Regjistri i vaksinave të kryera**

Përrjashtim nga vaksinimi

1. **Përrjashtim mjekësor.** Fëmijët nuk duhet të vaksinohen nëse një mjek, ose i punësuar i mjekut jep një deklaratë me shkrim se vaksinimi mund të jetë i dëmshëm për shëndetin e fëmijës. Kur mjeku konstaton se vaksinimi nuk është më i dëmshëm për shëndetin e fëmijës, fëmija vaksinohet sipas këtij nënkapitulli. Familjet duhet të dorëzojnë një formular të plotësuar përjashtimi tek infermierja e shkollës.
2. **Përrjashtim fetar.** Fëmijët nuk është e nevojshme të vaksinohen nëse prindi, kujdestari, ose fëmija i emancipuar kundërshton me shkrim vaksinimin për arsye fetare, ose për shkak të një bindjeje të fortë morale ose etike, e cila është e ngjashme me atë të besimit fetar. Familjet duhet të dorëzojnë një formular të plotësuar përjashtimi tek infermierja e shkollës.

Ju lutem vini re: Nëse një student ka filluar së fundmi një seri vaksine, ai mund të kryej regjistrimin. Studenti duhet patjetër të jetë në proces dhe të ndjekë afatin kohor të serisë së saj(p.sh. studenti sapo ka marrë dozën e parë dhe ai/ajo do të marrë dozën e dytë tridhjetë ditë nga doza e parë).

Ju lutem klikoni këtu për të parë kërkesat e vaksinimit për hyrjen në shkollë.

3. **Vërtetimi i adresës**

Për të vërtetuar vendbanimin e rrethit shkollor, prindërit/kujdestarët do të duhet të sjellin një akt, deklaratë hipotekore, ose një qira të plotë dhe të realizuar plotësisht dhe një formë **tjetër të dokumentacionit të aprovuar të vendbanimit**.

Nëse një akt, deklaratë hipotekore, ose një qira aktuale e plotë dhe plotësisht e realizuar nuk mund të sigurohet, prindërit/kujdestarët duhet të sjellin tre (3) formularë të dokumentacionit të miratuar të vendbanimit. Për të verifikuar vendbanimin, punonjësit e rrethit mund të kryejë një vizitë në shtëpi. Nëse do të kryhet vizita, kjo mund të kualifikohet si një (1) dëshmi e vendbanimit tuaj.

Dokumentacioni i miratuar i banimit përfshin:

| | |
|---|---|
| Fletëpagesa e HUD (Urbanizmi dhe Zhvillimi Urban) | Siguracioni i qiramarrësve/pronarëve |
| Fatura aktuale e shërbimeve - Elektrike/Uji/Kanalizime/Gaz/Vaj/Kabull/Intenet | Fatura e pagës së punëdhënësit të fundit që tregon adresën tuaj aktuale |
| Faturat utilitare, ose fatura e telefonit | Letër nga Zyra e Sigurimeve Shoqërore / Zyra e Ndihmës Publike |



| | |
|--|---|
| Deklarata e IRS-së ose deklarata të tjera për paga dhe tatime, p.sh., W2, 1040, 1099 | Fatura aktuale të kartës së kreditit |
| Regjistrimi aktual i automjetit | Pasqyra e fundit bankare me adresën aktuale |

*** Informacioni duhet të jetë brenda **nëntëdhjetë (90)** ditëve të fundit.

Duhet të theksohet se rrethi mund të kontaktojë qiradhënësin për verifikim, ose sqarim nëse e sheh të nevojshme.

Dokumentet e mëposhtme nuk **mund** të pranohen për të vërtetuar vendbanimin:

| | |
|--|--|
| Faturat ose deklaratat e vjetra | Patentë shoferi, ose karta e ndryshimit të adresës |
| Karta e regjistrimit të zgjedhësve | Karta e bibliotekës |
| Kartat e identifikimit të anëtarësisë | Posta e një adresë të mëparshme |
| Letra nga miqtë, ose familja që pohojnë adresën tuaj | Posta e përgjithshme reklamuese |
| Deklarata të paverifikueshme në internet | Dokumente të cilat nuk tregojnë qartë adresën tuaj aktuale dhe emrin e plotë ligjor. |

- Deklarata e regjistrimit të prindërve (Përfshirë në formularin e regjistrimit të studentëve EH-40 të dhënë nga shkolla):** Një deklaratë nën betim që vërteton nëse studenti është ndaluar, përjashtuar për shkelje që përfshijnë drogë, alkool, armë, shkaktim dëmtimi, ose dhunë në mesin e shkollës duhet të ofrohet për pranimin e studentit në çdo entitet shkollor. 24 P.S. §13-1304-A. Një shkollë nuk mund t'ia mohojë, ose ta vonojë regjistrimin në shkollë një fëmije mbështetur në informacionin që përmban një rekord disiplinor, ose një deklaratë nën betim.
- Anketa e gjuhës amtare (përfshirë në formularin e regjistrimit të nxënësve EH-40 të dhënë nga shkolla):** Në përputhje me kërkesat e Zyrës për të Drejtat Civile të Departamentit të Arsimit të Shteteve të Bashkuara, të gjithë nxënësve që po kërkojnë të regjistrohen për herë të parë në një shkollë do t'u jepet një anketë e gjuhës amtare. Regjistrimi i studentit nuk mund të vonohet për të administruar anketën e gjuhës amtare.